



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 960/8 prot.

Datë 24.04.2026

**V E N D I M**  
**Nr. 544/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.04.2026 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Modifikimin e dokumenteve të tenderit, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-79678-03-19-2026, me objekt “*Shërbim i lavanderisë për pacientët e hospitalizuar në pavionet e Spitalit Rajonal “Memorial” Fier*”, me fond limit 188,480,000 lekë pa TVSH, me datë mbyllje për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje 20.04.2026, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjve të Përqendruara.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Kombi Invest” SHPK me NIPT (K43407402P) dhe adresë: Lagja “Bishanake”, me nr. Pasurie 1/342-ND, Zona Kadastrale 8532, Fier.
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjve të Përqendruara, me adresë: Rruga “Reshit Çollaku”, godina nr. 6/337, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i

ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 25.03.2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-79678-03-19-2026,

me objekt “Shërbim i lavanderisë për pacientët e hospitalizuar në pavionet e Spitalit Rajonal “Memorial” Fier”, me fond limit 188,480,000 lekë pa TVSH, me datë mbyllje për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje 20.04.2026, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 30.03.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A2026/6461, dhe nr. 960/2026 prot., datë 30.03.2026, i operatorit ekonomik “Kombi Invest” SHPK, me anë të së cilit kërkohet modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi. Konkretisht operatori ekonomik ankimues pretendon:

*Kundershtojme kriterin e veçante të kualifikimit të referuar me poshte si kriter përjashtues, diskriminues dhe të paligjshëm:*

*2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:*

*2.2.1 Per te provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomike duhet të paraqesin vertetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kerkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.*

*Kërkesa e mesipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kerkuar.*

*1.Referuar procesverbalit për argumentimin e kriterëve të kualifikimit, rezulton se autoriteti kontraktor ka specifikuar se:*

*Argumentimi: Kërkesa e mesipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar. Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/a, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, ku është përcaktuar qarte vlera e kerkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 Për prokurimin publik, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-se nr7998 datë 24.12.2021.*

*Vlera e kerkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat me sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomik-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimesinë e veprimtarisë së operatoreve ekonomike në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.*

*Përcaktimi i viteve të kerkuara për paraqitjen e vertetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjisllacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 Për tatimin mbi të ardhurat si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.*

*2. Arsytimi i autoritetit kontraktor për kerkimin e xhiros jo për 3 vitet e fundit 2023-2024-2025, por për vitet 2022-2023-2024, është i gabuar dhe në shkelje të ligjit.*

3. *Ne piken 1 te nenit 43 Kerkesat per kapacitetet ekonomiko-financiare te VKM nr.285, date 19.05.2021 Per miratimin e rregullave te prokurimit publik , i ndryshuar, percaktohet shume qarte se: [...]*
4. *Ne nenin 41 Kerkesa te veçanta per kontratat e sherbimeve , pika 2, te VKM nr.285, date 19.05.2021 Per miratimin e rregullave te prokurimit publik , i ndryshuar, parashikohet se:*
5. *Autoriteti kontraktor ka referuar nenin 61 Deklarata tatimore vjetore te Ligjit nr. 29/2023 Per tatimin mbi te ardhurat si baze ligjore per vendosjen e ketij kriteri kualifikimi.*
6. *Megjithate, nga permbajtja e kesaj dispozite rezulton se ajo parashikon si me poshte:*
  1. *Çdo person, qe i nenshtrohet ketij ligji, eshte i detyruar te deklaroje ne organin tatimor te gjitha te ardhurat, qofshin ato te tatuara ne çfaredo menyre apo te perjashtuara nga tatimi. Per personat fizike qe jane nen 18 vjeç deklarata tatimore behet nga kujdestari i tyre ligjor.*
  2. *Deklarata tatimore vjetore dorezohet ne organin tatimor jo me vone se data 31 mars e vitit pasardhes te vitit tatimor per te cilin dorezohet deklarata.*
  3. *Ne rast se tatimpaguesi ka vdekur, deklarata plotesohet nga trashegimtaret e tij ligjore per te ardhurat e pergjithshme te krijuara deri ne daten e vdekjes.*
  4. *Ne rast se tatimpaguesi ndryshon rezidencen tatimore, ai duhet te beje deklarate tatimore per çdo te ardhur te krijuar deri ne daten e ndryshimit te rezidences.*
  5. *Menyra e deklarimit, perfshire deklarimin elektronik, dhe formularet perkates te deklarimit, paraqiten sipas percaktimeve ne udhezimin e ministrit pergjegjes per financat per zbatimin e ketij ligji. Tatimpaguesit qe mbajne kontabilitet sipas kerkesave te ligjit perkates, paraqesin deklaraten vjetore se bashku me pasqyrat financiare, si dhe te dhena te tjera te percaktuara ne udhezimin e ministrit pergjegjes per financat per zbatimin e ketij ligji.*
  6. *Tatimi per tu paguar nga tatimpaguesi paguhet ne llogarite e autorizuar nga thesari i buxhetit te shtetit.*
  7. *Kjo dispozite nuk ka asnje lidhje me qarkullimin e realizuar nga nje subjekt deri ne daten 31 dhjetor te vitit perkates, por rregullon dorezimin e deklaratave tatimore vjetore, ku perfshihen edhe pasqyrat financiare (bilancet).*
  8. *Per kete arsye, kerkesa per xhiro per vitet 2022-2023-2024 eshte ne kundërshtim me dispozitat ligjore te referuara me siper, pasi ne rastin konkret duhet te kerkohet xhiro e 3 viteve te fundit financiare, konkretisht 2023-2024-2025.*
- Viti 2025 perben nje vit financiar te mbyllur me date 31.12.2025 dhe, si i tille, qarkullimi per kete vit eshte i verifikueshem dhe mund te aksesohet lehtesisht permes platformes e-Albania.*
- Ne keto kushte, perjashtimi i operatoreve ekonomike qe permbushin kriterin e kualifikimit bazuar ne xhiron e realizuar ne vitin 2025, dhe jo ne vitin 2024, perben nje kufizim te pajustificuar te konkurrences, duke sjelle perjashtim nga gara pa filluar ende dhe duke e bere kete kriter teresisht diskriminues.*
9. *Autoriteti kontraktor ka referuar gjithashtu Ligjin nr. 25/2018 Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare , si baze ligjore per vendosjen e kriterit te kualifikimit.*
10. *Ne kete kuader, nga verifikimi i dispozitave perkatese, konkretisht neni 9 Periudha raportuese , rezulton se:*

1. Kohezgjatja e periudhes raportuese eshte 12 muaj.
  2. Periudha raportuese fillon ne daten 1 janar dhe perfundon ne daten 31 dhjetor. [...]
  11. Nga kjo dispozite del qarte se periudha raportuese financiare per subjektet ekonomike perkon me vitin kalendarik dhe perfundon me date 31 dhjetor te çdo viti.
  12. Ne kete kuptim, edhe per qellime kontabel dhe raportimi financiar, viti 2025 perben nje periudhe te mbyllur dhe te plote, e cila duhet te merret ne konsiderate si nje nga 3 vitet e fundit financiare.
  13. Per rrjedhoje, perjashtimi i vitit 2025 nga kriteri i kualifikimit, duke marre ne konsiderate vitin 2022, bie ne kundershtrim jo vetem me legjislacionin per prokurimin publik, por edhe me vete legjislacionin kontabel te referuar nga autoriteti kontraktor.
  14. Ky fakt tregon se referimi i bere nga autoriteti kontraktor ne Ligjin nr. 25/2018 nuk justifikon kriterin e vendosur, por perkundrazi, e pergenjeshtron ate.
  15. Sjellim ne vemendje te autoritetit kontraktor nenin 6 Viti tatimor te Ligjit nr. 29/2023 Per tatimin mbi te ardhurat , i cili percakton ne menyre te qarte dhe pa asnje ekuivok se: Viti tatimor fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 dhjetor te çdo viti kalendarik.
  16. Nga kjo dispozite rezulton se viti financiar 2025 eshte nje vit tatimor i perfunduar plotesisht me date 31.12.2025 dhe, si i tille, perben nje periudhe te mbyllur dhe te verifikueshme per qellime te vleresimit te kapaciteteve ekonomiko-financiare te operatoreve ekonomike.
  17. Per rrjedhoje, perjashtimi i ketij viti nga kriteri i kualifikimit, nderkohe qe ai perben nje nga 3 vitet e fundit financiare, bie ndesh me logjiken e vete dispozites ligjore dhe me kerkesen per vleresim te situates ekonomike aktuale te operatoreve ekonomike.
  18. Ne keto kushte, kerkesa per te marre ne konsiderate vitet 2022-2023-2024, duke perjashtuar vitin 2025, perben nje kufizim te pajustificuar dhe te paarsyeshem, i cili cenon konkurrencen dhe vendos ne menyre te padrejte ne disavantazh operatoret ekonomike qe permbushin kriterin ne baze te performances se tyre me te fundit financiare.
  19. Per sa me siper, kerkojme ndryshimin e kriterit te kualifikimit te referuar me siper, si vijon:
- 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:
- 2.2.1 Per te provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatoret ekonomike duhet te paraqesin vertetim per xhiron vjetore te 3 (tre) viteve te fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros per te pakten nje nga vitet e periudhes se kerkuar duhet te jete jo me e vogel se vlera e fondit limit.
- Kerkesa e mesiperme konsiderohet e permbushur nese operatoret ekonomike arrijne vleren e xhiros minimale ne te pakten nje vit te periudhes se kerkuar.

II. Kundershtojme kriterin e veçante te kualifikimit te referuar me poshte si kriter perjashtues, diskriminues dhe te paligjshem:

Stafi

2.3.5 Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht 13 (trembëdhjetë) persona të punësuar, në profilet sipas tabelës si mëposhtme:

NR.	Stafi	Nr.
-----	-------	-----

<b>1</b>	<i>Përgjegjës Shërbimi</i>	<i>1 (një)</i>
<b>2</b>	<i>Punëtorë në Lavanderi</i>	<i>5 (pesë)</i>
<b>3</b>	<i>Punonjës Shërbimi në Reparte në AK</i>	<i>7 (shtatë)</i>
	<b><i>Totali i punonjësve</i></b>	<b><i>13 (trembëdhjete)</i></b>

a) Përgjegjësi i shërbimit, duhet të jetë me profesion kimist/bioteknolog/inxhinier mjedisi duhet të ketë eksperiencë pune të ngjashme të paktën 2 (dy) vite.

Për Përgjegjësin e shërbimit, OE duhet të paraqesë:

- Kontratë individuale pune (e vlefshme), si Përgjegjës shërbimi;
- Diplomë e arsimit të lartë;
- Librezë pune/ deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekpseriencën e kërkuar.

b) Për punonjësit në pikat 2, 3 në tabelën më sipër, të paraqitet kontratë individuale pune (e vlefshme) përkatëse.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 12 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga të gjithë kandidatët e kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

20. Kërkesa që Përgjegjësi i shërbimit duhet të jetë me profesion kimist/bioteknolog/inxhinier mjedisi dhe të ketë eksperiencë pune të ngjashme të paktën 2 (dy) vite është e pabazuar në ligj dhe e pajustificuar në raport me natyrën e shërbimit objekt prokurimi.

21. Në lidhje me këto kriter, ankuesi nuk kundërshton kërkesën për një profil të caktuar profesional për përgjegjësin e shërbimit, por kundërshton kërkesën shtesë për eksperiencë të detyrueshme prej të paktën 2 (dy) vitesh, si një kusht të panevojshëm dhe disproporcional.

22. Në legjislacionin për prokurimin publik nuk ekziston asnjë dispozitë që imponon detyrimisht një nivel të tillë eksperiencë për këto kategori shërbimi, nderkohe që vete autoriteti kontraktor nuk ka dhënë një argumentim konkret që të justifikojë domosdoshmerinë e kësaj kërkesë.

23. Për më tepër, kërkesa për eksperiencë të caktuar për një profil të caktuar profesional përben një kufizim të pajustificuar të konkurrencës, pasi përjashton operatore ekonomike që janë plotësisht të aftë për realizimin e shërbimit, por që nuk disponojnë pikërisht këto kriter shtesë.

24. Një kërkesë e tillë bie ndesh me parimet e proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit të operatoreve ekonomike, të parashikuara në legjislacionin për prokurimin publik, duke krijuar barriera artificiale për pjesëmarrjen në procedurë.

25. Edhe nëse do të pranohej kërkesa për një profil të caktuar profesional, vendosja e një kriteri shtesë për eksperiencë të detyrueshme përben një kufizim të panevojshëm dhe disproporcional.

26. Në këto kuader, duhet theksuar se vete autoriteti kontraktor ka parashikuar në kriterin 2.3.1 kërkesën për përvojë në shërbime të ngjashme, duke kërkuar që operatori ekonomik të paraqesë dëshmi për shërbime të mëparshme të realizuara gjatë tre viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit, të vërtetuara përmes dokumentacionit përkatës.

27. Ky kriter, ne vetvete, perben nje garanci te plote dhe te mjaftueshme per aftesine teknike dhe profesionale te operatoreve ekonomike, pasi demonstroi pervojat reale dhe te provuar ne realizimin e sherbimeve te ngjashme.

28. Ne keto kushte, vendosja paralelisht e nje kriteri shtese, i cili kerkon nje eksperience te detyrueshme per pergjegjesin e sherbimit, rezultoi e tepert dhe disproporcionale, duke mos qene e lidhur ngushte me objektin e kontrates dhe duke kufizuar ne menyre te pajustificuar konkurrencen.

29. Per rrjedhoje, autoriteti kontraktor ka tejkualuar kufijte e arsyeshmerise ne vendosjen e kriterave te kualifikimit, duke vendosur kerkesa qe nuk jane te nevojshme per garantimin e realizimit te kontrates, ne kundërshtim me parimet e proporcionalitetit dhe barazise ne prokurimin publik.

30. Akoma me tej, referuar faqes 94-95 te Vendimit Nr. 514, date 20.09.2017 Per miratimin e listes kombetare te profesioneve (LKP), te rishikuar, percaktohet se: Kimiste Kodi i profesionit: 2113 Pershkrim i pergjithshem i grupit te profesioneve Kimiste, niveli i katert i kompetences ne LKP. Kimisti/ja ben kerkime, hulumtime dhe analiza ne mbështetje te operacioneve te prodhimit industrial, proceseve te zhvillimit, kontrollit te cilesise, kontrollit mjedisor, diagnostikimit dhe trajtimit mjekesor, bioteknologjise, aplikimin e qasjeve te reja teorike, ne lidhje me kimine, per te zhvilluar produkte te reja. Ai/Ajo kryen eksperimente, teste dhe analiza per te hetuar mbi perberjen kimike, energjine dhe ndryshimet kimike ne substanca, materiale apo produkte te ndryshme natyrale ose sintetike, per mbledhjen dhe analizimin e mostrave dhe te dhenave per te identifikuar dhe llogaritur sasine e toksikanteve ne mjedis, duke bashkepunuar me inxhinier kimie, biologe, mikrobiologe, agronome, gjeologe ose profesioniste te tjere. Ai/Ajo mund te punesohet ne institucione apo ne laboratore kerkimore, te zhvillimit dhe kontrollit te cilesise, ne laboratore kimike, petrokimike dhe te industrise farmaceutike e minerale, ne institucione te sherbimeve shendetesore, arsimore qe ofrojne sherbime te fushen kimise apo te vetepunesohet. Funkcionet kryesore Kimistet kryejne nje pjese ose teresine e funksioneve te meposhtme, sipas menyres se organizimit te punes: [...]

31. Nga sa me sipër del qarte se dispozita ligjore nuk vendos barriera per nje kimist ne lidhje me eksperiencen ne menyre qe ai te ushtroje detyrat dhe te punesohet.

32. Per rrjedhoje, autoriteti kontraktor ka tejkualuar kufijte e arsyeshmerise ne vendosjen e kriterave te kualifikimit, duke vendosur kerkesa qe nuk jane te nevojshme per garantimin e realizimit te kontrates, ne kundërshtim me parimet e proporcionalitetit dhe barazise ne prokurimin publik

33. Per arsyet e analizuara me sipër, kerkojme ndryshimin e kriterit si ne vijim:

2.3.5 Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht 13 (trembëdhjetë) persona të punësuar, në profilet sipas tabelës si mëposhtme:

<b>NR.</b>	<b>Stafi</b>	<b>Nr.</b>
<b>1</b>	<b>Përgjegjës Shërbimi</b>	<b>1 (një)</b>
<b>2</b>	<b>Punëtore në Lavanderi</b>	<b>5 (pesë)</b>
<b>3</b>	<b>Punonjës Shërbimi në Reparte në AK</b>	<b>7 (shtatë)</b>

<b>Totali i punonjësve</b>	<b>14 (trembëdhjete)</b>
----------------------------	--------------------------

c) Përgjegjësi i shërbimit,

Për Përgjegjësin e shërbimit, OE duhet të paraqesë:

- Kontratë individuale pune (e vlefshme), si Përgjegjës shërbimi;

d) Për punonjësit në pikat 2, 3 në tabelën më sipër, të paraqitet kontratë individuale pune (e vlefshme) përkatëse.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 12 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga të gjithë kandidatët e kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

III)Kundershtojme kriterin e veçante të kualifikimit 2.3.6 si kriter të paligjshëm, disproportional dhe kufizues të konkurrencës:

2.3.6 Operatoret ekonomike ofertues duhet të deklarojnë se punonjësit e deklaruar për këtë procedurë prokurimi: Punonjës Shërbimi në Repartë në AK nuk do të jenë të angazhuar në kontrata të tjera gjatë periudhës së vlefshmerisë së marrëveshjes kuader.

34. Ky kriter përben një kufizim të drejtëpërdrejtë dhe të pajustificuar të mënyrës së organizimit të brendshëm të operatoreve ekonomike, duke nderhyrë në marrëdhëniet e tyre të punës dhe në të drejtën për të menaxhuar burimet njerezore në mënyrë të lirë.

35. Në legjislacionin për prokurimin publik nuk ekziston asnjë dispozitë që lejon autoritetin kontraktor të vendosë kufizime të tilla mbi punësimin e stafit të operatoreve ekonomike, përtej kërkesave që lidhen me aftësinë për realizimin e kontratës.

36. Punonjësit, në përputhje me legjislacionin e punës, janë të angazhuar për një kohë pune të caktuar (p.sh. 8 orë në ditë) dhe nuk ekziston asnjë ndalim ligjor që ata të mos angazhohen në më shumë se një kontratë apo aktivitet, për sa kohë respektohen kufijtë ligjorë të kohës së punës.

37. Për rrjedhojë, kërkesa që punonjësit të mos jenë të angazhuar në kontrata të tjera gjatë gjithë periudhës së vlefshmerisë së marrëveshjes kuader përben një kufizim të pajustificuar dhe të tepruar, i cili nuk lidhet në mënyrë proporcionale me objektin e kontratës.

38. Edhe argumentimi i autoritetit kontraktor, i cili mbështetet në ndjeshmerinë e shërbimit dhe nevojën për realizim në kohë, nuk justifikon një kufizim absolut të tillë, pasi realizimi i shërbimit në kohë dhe me çilesi garantohet përmes organizimit të brendshëm të operatorit ekonomik dhe jo përmes ndalimit të angazhimit të stafit në aktivitete të tjera.

39. Në këtë kuptim, autoriteti kontraktor ka tejkaluar kufijtë e parashikuar në nenin 41 të VKM nr. 285/2021, pasi kriteret e vendosura duhet të jenë të lidhura ngushtë dhe proporcionale me objektin e kontratës, dhe jo të nderhyjnë në mënyrë të pajustificuar në lirinë ekonomike dhe organizative të operatoreve ekonomike.

40. Për më tepër, një kriter i tillë kufizon ndjeshëm konkurrencën, pasi favorizon operatorët ekonomikë që disponojnë staf të dedikuar ekskluzivisht për këtë kontratë, duke përjashtuar operatorë të tjerë që organizojnë aktivitetin e tyre në mënyrë efektive dhe të ligjshme përmes angazhimit të stafit në disa kontrata.

41. Ne keto kushte, kriteri rezulton diskriminues dhe ne kundërshtim me parimet e proporcionalitetit dhe barazisë në prokurimin publik.

42. Për rrjedhojë, kërkojmë heqjen e këtij kriteri si një kërkesë e paligjshme dhe e pajustificuar.

IV) Kundërshtojmë kriterin e veçantë të kualifikimit 2.3.7 si kriter të pajustificuar, disproporcional dhe kufizues të konkurrencës:

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se disponon, makineritë, dhe pajisjet, si më poshtë:

<b>Nr</b>	<b>Emri i mjetit</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasitë minimale</b>
1	Makinë larëse profesionale (me kapacitet mbi 60 kg secila)	copë	2 (dy) ose me kombinim pajisjesh, për plotësimin e sasisë së përcaktuar nga AK.
2	Barriera larëse profesionale (për larjen e materialeve të kontaminuara) me kapacitet mbi 60 kg secila.	copë	1 (një) ose me kombinim pajisjesh, për plotësimin e sasisë së përcaktuar nga AK.

43. Kriteri i mësipërm në lidhje me kapacitetin e makinave larëse dhe barrierave larëse profesionale mbi 60 kg secila, përben një kufizim të pajustificuar të konkurrencës, pasi përcakton në mënyrë të ngurtë dhe të tepruar kapacitete minimale të pajisjeve, pa një lidhje reale dhe proporcionale me volumin e shërbimit që kërkohej të realizohej.

44. Referuar shtojcës 9 FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT të publikuar në DSt nga vete autoritetit kontraktor, rezulton se sasia totale e shërbimit për 48 muaj është 496,000 kg.

45. Kjo periudhë përkon me 4 vite kalendarike, pra:

-  $48 \text{ muaj} \div 12 = 4 \text{ vite}$

-  $4 \text{ vite} \div 365 \text{ dite} = 1,460 \text{ dite}$

46. Në keto kushte, volumni mesatar ditor i shërbimit rezulton si më poshtë:

$496,000 \text{ kg} \div 1,460 \text{ dite} = \text{rreth } 340 \text{ kg/dite}$

Pra, autoriteti kontraktor kërkon realizimin e një shërbimi me volumn mesatar ditor prej rreth 340 kg/dite.

48. Edhe duke marrë në konsideratë pajisje me kapacitete më të ulëta se ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor (p.sh. 30 kg), mund të realizojë minimalisht 4 cikle në ditë.

49. Në keto kushte, kapaciteti ditor i një pajisjeje të tillë rezulton:

-  $30 \text{ kg} \div 4 \text{ cikle/dite} = 120 \text{ kg/dite}$

50. Për të përballuar volumnin mesatar ditor prej rreth 340 kg/dite, nevojiten:

-  $340 \text{ kg/dite} \div 120 \text{ kg/dite} = \text{jo më shumë se } 3 \text{ makina larëse.}$

51. Pra, edhe në një skenar konservativ, me cikle të kufizuara gjatë ditës, një numër i kufizuar pajisjesh është i mjaftueshëm për realizimin e plote të shërbimit.

52. Nga analiza e mësipërme rezulton se edhe me pajisje profesionale me kapacitete më të ulëta se ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor (p.sh. 30 kg), shërbimi realizohet plotësisht, çka

*tregon se kerkesat e vendosura jane te tepruara dhe jo proporcionale me nevojat reale te kontrates.*

*53. Nderkohe, autoriteti kontraktor kerkon nje numer dhe kapacitet pajisjesh qe tejkalon ndjeshem kete nevoje minimale, duke krijuar nje kapacitet disa here me te larte se ai qe kerkohet realisht per realizimin e kontrates.*

*54. Gjithashtu, rezulton se autoriteti kontraktor ka vendosur kerkesa te ndryshme dhe jo te njetrajtshme per kapacitetet e pajisjeve, duke kerkuar per makinerite larese dhe barrierat larese kapacitet mbi 60 kg, ndersa per makinat e pastrimit kimik (per jorgan, vatine dhe jastek) dhe makinat tharesore profesionale kapacitet mbi 20 kg.*

*55. Kjo mosperputhje ne percaktimin e kapaciteteve minimale nuk shoqerohet me asnje arsytim teknik konkret dhe te verifikueshem nga autoriteti kontraktor.*

*56. Ne kete kuader, nuk rezulton e qarte perse per disa pajisje kerkohet nje kapacitet minimal prej mbi 60 kg, nderkohe qe per pajisje te tjera qe jane pjese e te njejtit zinxhir procesi (si tharja dhe perpunimi pas larjes) kerkohet nje kapacitet ndjeshem me i ulet, pa nje justifikim teknik apo funksional.*

*57. Ne mungese te nje justifikimi te qarte dhe proporcional, vendosja e kapaciteteve te tilla specifike dhe te fragmentuara rezulton e pajustificuar dhe krijon dyshime te arsyeshme mbi menyren e percaktimit te ketyre kerkesave.*

*58. Per rrjedhoje, nje strukture e tille kriteresh mund te çoje ne favorizimin e operatoreve ekonomike qe disponojne pikerisht kete konfigurim te caktuar pajisjesh, ne dem te konkurrences se lire dhe te barabarte.*

*59. Nga analiza e procesverbalit te argumentimit te kriterëve te kualifikimit rezulton se arsyetimi i autoritetit kontraktor mbetet ne nje nivel te pergjithshem dhe teorik, pa permbajtur asnje analize konkrete teknike mbi nevojat reale te sherbimit.*

*60. Ne menyre te veçante, autoriteti kontraktor kufizohet ne nje pershkrim te pergjithshem te proceseve te sherbimit te lavanderise, si larja, tharja, hekurosja dhe garantimi i higjenes ne ambiente spitalore, pa bere asnje lidhje konkrete midis ketyre proceseve dhe kapaciteteve specifike te pajisjeve te kerkuara.*

*61. Ne asnje moment nuk jepet nje analize numerike apo teknike qe te justifikojë perse kerkohen pikerisht keto kapacitete minimale, ne raport me volumin real te sherbimit qe duhet te realizohet.*

*62. Gjithashtu, referimi i pergjithshem ne rendesine e higjenes apo ne natyren spitalore te sherbimit nuk perben ne vetvete nje justifikim te mjaftueshem per vendosjen e kriterëve konkrete teknike, pasi keto duhet te mbesheten ne analiza te matshme dhe te verifikueshme.*

*63. Ne kete kuader, procesverbali i argumentimit nuk demonstroi nje lidhje te drejtperdrejte dhe proporcionale midis kerkesave per pajisje dhe nevojave reale te kontrates, por mbetet ne nivel deklarativ, pa ofruar nje baze teknike te qendrushme per kriteret e vendosura.*

*64. Ne keto kushte, kriteri nuk rezulton i lidhur ngushte me objektin e kontrates dhe as proporcional me volumin e saj, ne kundërshtim me nenin 77 te Ligjit per Prokurimin Publik dhe nenin 41 te VKM nr. 285/2021.*

65. Per rrjedhoje, kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor per kapacitetin e pajisjeve eshte i pajustificuar dhe diskriminues, pasi vendos kerkesa qe nuk jane te nevojshme per realizimin e kontrates dhe kufizojne ne menyre te padrejte pjesemarrjen ne procedure.

66. Ne keto kushte, kerkojme rishikimin e ketij kriteri, duke e ndryshuar si ne vijim:

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të deklaroje se disponon, makinerite, dhe pajisjet, si më poshtë:

<b>Nr</b>	<b>Emri i mjetit</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasitë minimale</b>
1	Makinë larëse profesionale(me kapacitet mbi 30 kg secila)	copë	2 (dy) ose me kombinim pajisjesh, per plotesimin e sasise se percaktuar nga AK.
2	Barriera larese profesionale (për larjen e materialeve të kontaminuara) me kapacitet mbi 30 kg secila.	copë	1 (nje) ose me kombinim pajisjesh, per plotesimin e sasise se percaktuar nga AK.

V) Kundershtojme kriterin e veçante te kualifikimit 2.3.7 si kriter te pajustificuar, disproporcional dhe kufizues te konkurrences:

“Makine pastrimi kimik profesionale (per jorgan, vatine dhe jastek, me kapacitet mbi 20 kg) 1 (nje) ose me kombinim pajisjesh, per plotesimin e sasise se percaktuar nga AK “ si kriter diskriminues dhe perjashtues.

67. Ne perputhje me parimin e proporcionalitetit, kriteret teknike te vendosura nga autoriteti kontraktor duhet te jene te lidhura drejtperdrejt dhe ne menyre te arsyeshme me nevojat reale te kontrates.

68. Ne rastin konkret, autoriteti kontraktor nuk ka paraqitur asnje analize teknike apo numerike qe te justifikojte vendosjen e nje kapaciteti minimal mbi 20 kg per pajisjen e pastrimit kimik per jorgan, vatine dhe jastek.

69. Per me teper, referuar Shtojces 8 “Specifikimet Teknike te Menaxhimit te Procesit te Lavanderise”, rezulton se frekuenca e larjes per keto artikuj eshte e kufizuar dhe jo e perditshme, konkretisht:

- Jorganet dhe batanijet lahen minimalisht 1 (nje) here ne vit dhe vetem sipas nevojës;

- Jasteket lahen minimalisht 4 here ne vit dhe vetem sipas nevojës.

70. Nga keto te dhena rezulton qarte se volumi i pastrimit kimik per keto artikuj eshte i ulet dhe sporadik ne raport me sherbimin total te lavanderise.

71. Edhe duke marre ne konsiderate nje skenar maksimal teorik, ku keta artikuj perbejne nje pjese shume te kufizuar te volumit total prej 496,000 kg per 48 muaj, rezulton se volumi i tyre i pervitshem dhe ditor mbetet i paperfillshem ne raport me kapacitetet e kerkuara.

72. Ne menyre ilustrative, edhe nese do te supozohej nje volum prej disa qindra kilogramesh ne muaj per keto artikuj (çka perben nje vleresim maksimal), kjo perkthehet ne vetem disa kilograme ne dite, shume larg kapacitetit prej mbi 20 kg per çdo cikël.

73. Ne keto kushte, vendosja e nje kerkese te veçante per pajisje me kapacitet minimal mbi 20 kg per kete kategori artikujsh nuk rezulton e justifikuar nga pikepamja teknike dhe as proporcionale me nevojat reale te kontrates.

74. Ne mungese te nje justifikimi te qarte dhe te matshem, nje kerkese e tille mbetet arbitrare dhe krijon nje barriere te panevojshme per pjesemarrjen ne procedure.

75. Per rrjedhoje, kriteri ne fjale eshte diskriminues dhe perjashtues, si dhe bie ne kundershtrim me nenin 77 te Ligjit nr. 162/2020 Per Prokurimin Publik dhe nenin 41 te VKM nr. 285/2021, pasi nuk eshte i lidhur ne menyre proporcionale me objektin e kontrates dhe tejkalon ate qe eshte e nevojshme per realizimin e saj.

76. Per sa me siper, kerkojme ndryshimin e kriterit te kualifikimit si ne vijim:

“Makine pastrimi kimik profesionale (per jorgan, vatine dhe jastek) 1 (nje) ose me kombinim pajisjesh, per plotesimin e sasise se percaktuar nga AK duke hequr kufizimin e pajustificuar mbi kapacitetin minimal, pasi i njejti nuk mbeshetet ne asnje analize teknike apo numerike dhe nuk rezulton proporcional me nevojat reale te kontrates.

VI)Kundershtojme kriterin e veçante te kualifikimit 2.3.7 si kriter te pajustificuar, disproporcional dhe kufizues te konkurrences:

“Peshore elektronike mbi 100 kg, e cila duhet te jete e kalibruar dhe te shoqerohet me akt kolaudimi te leshuar nga autoritetet perkatese (Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise) 2 (dy) cope si kriter te pajustificuar, disproporcional dhe kufizues te konkurrences.”

77.Ne perputhje me parimin e proporcionalitetit, kerkesat teknike duhet te jene te lidhura drejtperdrejt me funksionin qe ato kryejne ne realizimin e kontrates.

78. Ne rastin konkret, funksioni i peshores eshte matja e peshes se materialeve te perpunuara ne kuader te sherbimit te lavanderise, e cila shprehet ne kilograme dhe mund te realizohet ne menyre te plote dhe te sakte edhe permes matjeve te pjesshme dhe kumulative.

79. Ne kete kuader, nuk rezulton e justifikuar perse kerkohet ne menyre specifike nje peshore me kapacitet mbi 100 kg, kur matja e sasise se materialeve mund te realizohet permes disa matjeve te njepasnjeshme me pajisje me kapacitete me te uleta.

80. Referuar procesverbalit per argumentimin e kriterëve te kualifikimit, rezulton se autoriteti kontraktor nuk ka arritur te justifikojë ne menyre konkrete dhe te matshme nevojën per vendosjen e nje kapaciteti minimal mbi 100 kg per peshoren e kerkuar.

81. Ne menyre te veçante, autoriteti kontraktor kufizohet ne nje arsyetim te pergjithshem, duke theksuar se disponimi i peshores lidhet me faktin qe njesia matese e kontrates eshte kilogrami dhe me nevojën per garantimin e cilesise se sherbimit.

82. Megjithate, ky arsyetim nuk permban asnje analize teknike apo funksionale qe te shpjegoje perse kerkohet pikerisht nje kapacitet mbi 100 kg dhe jo nje kapacitet tjeter me i ulet, i cili do te mundesonte realizimin e se njejtës funksionalitet permes matjeve te pjesshme dhe kumulative.

83. Gjithashtu, referimi ne rendesine e proceseve te lavanderise apo ne garantimin e higjenes ne ambiente spitalore nuk ka lidhje te drejtperdrejte me kapacitetin konkret te peshores, pasi keto

*elemente lidhen me cilesine e perpunimit te materialeve dhe jo me menyren teknike te matjes se peshes.*

*84. Ne keto kushte, procesverbali i argumentimit mbetet ne nivel deklarativ dhe nuk demonstroi nje lidhje te drejtperdrejte dhe proporcionale midis kerkeses per peshore mbi 100 kg dhe nevojave reale te kontrates.*

*85. Ne mungese te nje justifikimi te qarte dhe te matshem, kerkesa per peshore me kapacitet mbi 100 kg rezultoi e pajustificuar dhe vendos nje kufizim te panevojshem per pjesemarrjen ne procedure.*

*86. Per rrjedhoje, kriteri ne fjale eshte disproporcional dhe diskriminues, si dhe bie ne kundërshtim me nenin 77 te Ligjit nr. 162/2020 Per Prokurimin Publik dhe nenin 41 te VKM nr. 285/2021, pasi nuk eshte i lidhur ne menyre proporcionale me objektin e kontrates dhe tejkalon ate qe eshte e nevojshme per realizimin e saj.*

*87. Ne keto kushte, kerkojme ndryshimin e ketij kriteri duke e formuluar si me poshte:*

*“Peshore elektronike e kalibruar dhe e shoqeruar me akt kolaudimi te leshuar nga autoritetet perkatese (Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise) 2 (dy) cope duke hequr kufizimin e pajustificuar mbi kapacitetin minimal.”*

*VII) Kundërshtojme percaktimin ne Dokumentet Standarde te Tenderit, pika 2.16 “Mbeshtetja ne kapacitetet e subjekteve te tjera , si ne kundërshtim me legjislacionin ne fuqi per prokurimin publik dhe si kufizim i pajustificuar i konkurrences.”*

*88. Autoriteti kontraktor ka percaktuar se operatoret ekonomike ndalohen te mbeshteten ne kapacitetet e subjekteve te tjera per plotesimin e kriterëve te kualifikimit 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar dhe 2.3 Kapaciteti teknik .*

*89. Ky percaktim bie ne kundërshtim te drejtperdrejte me nenin 84 te Ligjit nr. 162/2020 Per Prokurimin Publik , i cili parashikon shprehimisht se operatori ekonomik ka te drejte te mbeshtetet ne kapacitetet ekonomike, financiare dhe teknike te subjekteve te tjera, pavaresisht natyres juridike te lidhjeve me to.*

*90. Ne menyre te veçante, kufizimi i vendosur nga autoriteti kontraktor tejkalon edhe parashikimin e pikës 7 te nenit 84, e cila lejon kufizime vetem per detyra apo aspekte kritike te kontrates, dhe jo ne menyre te pergjithshme per te gjitha kapacitetet ekonomike dhe teknike te kerkuara.*

*91. Ne rastin konkret, autoriteti kontraktor ka vendosur nje ndalim te pergjithshem dhe absolut per mbeshtetjen ne kapacitetet e subjekteve te tjera per dy nga kriteret kryesore te kualifikimit, pa bere asnje diferencim apo analize konkrete mbi cilat jane konkretisht aspektet kritike te kontrates.*

*92. Argumentimi i paraqitur nga autoriteti kontraktor, i cili lidhet me rendesine e sherbimit, kohezgjatjen e kontrates dhe natyren spitalore te tij, mbetet ne nivel deklarativ dhe nuk justifikon nje kufizim kaq te gjere dhe te pergjithshem te se drejtes se operateve ekonomike per tu mbeshtetur ne kapacitetet e subjekteve te tjera.*

*93. Ne fakt, vete ligji parashikon mekanizma te mjaftueshem per te garantuar realizimin e*

*kontrates, si p.sh.:*

- detyrimin per te provuar venien ne dispozicion te burimeve;*
- pergjegjesine solidar ndermjet operatorit ekonomik dhe subjektit mbeshtetes;*
- verifikimin e kushteve te kualifikimit edhe per subjektin mbeshtetes.*

*94. Ne keto kushte, vendosja e nje ndalimi te pergjithshem per mbeshtetjen ne kapacitetet e subjekteve te tjera perben nje kufizim te pajustificuar dhe disproporcional te konkurrences, duke perjashtuar operatore ekonomike qe, ne perputhje me ligjin, mund te realizojne kontraten permes bashkepunimit dhe perdorimit te burimeve te subjekteve te tjera.*

*95. Per rrjedhoje, kjo dispozite eshte ne kundersizim me nenin 84 te Ligjit nr. 162/2020 Per Prokurimin Publik , si dhe me parimet themelore te konkurrences, proporcionalitetit dhe trajtimit te barabarte.*

*96. Ne keto kushte, kerkojme shfuqizimin e ketij kufizimi dhe lejimin e operatoreve ekonomike per tu mbeshtetur ne kapacitetet e subjekteve te tjera, ne perputhje me nenin 84 te ligjit.*

*VIII) Kundershtojme Dokumentet Standarde te Tenderit per mangesi ne dhenien e informacionit thelbesor per proceduren.*

*97. Nga shqyrtimi i Dokumenteve Standarde te Tenderit rezulton se ne asnje pjese te tyre nuk specifikohet qarte nese procedura e prokurimit zhvillohet me nje faze apo me dy faza.*

*98. Mungesa e ketij informacioni thelbesor krijon paqartesi dhe konfuzion per operatoret ekonomike, duke lene vend per interpretime dhe keqinterpretime ne lidhje me menyren e zhvillimit te procedures dhe permbushjen e kerkesave perkatese.*

*99. Autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor qe ne Dokumentet Standarde te Tenderit te percaktojte ne menyre te qarte, te plote dhe te paekuivok te gjithe elementet thelbesore te procedures se prokurimit, ne menyre qe te garantohet transparencja, barazia dhe konkurrenca efektive ndermjet operatoreve ekonomike.*

*100. Ne mungese te ketij specifikimi, Dokumentet e Tenderit rezultojne te paplota dhe ne kundersizim me parimet e transparences dhe qartesis se procedures.*

*101. Per rrjedhoje, kerkojme plotesimin e Dokumenteve Standarde te Tenderit, duke specifikuar qarte nese procedura e prokurimit zhvillohet me nje faze apo me dy faza.*

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Gjithashtu, në datë 01.04.2026, protokolluar me tonën me nr.960/1, operatori ekonomik ankimues ankesën e mësipërme, e ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik edhe në formë shkresore, nëpërmjet shërbimit postar.

II.5. Në datë 07.04.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, protokolluar më tonën me nr.960/2, si dhe me anë të shkresës nr.1406/7 prot., datë 03.04.2026 me objekt “Mbi shqyrtimin e ankesë së paraqitur nga operatori ekonomik “Kombi Invest” shpk, lidhur me dokumentat e tenderit, në procedurën e prokurimit me nr. Ref-79678-03-19-2026, me objekt “Shërbim i lavanderisë për pacientët e hospitalizuar në pavionet e Spitalit Rajonal Memorial” Fier”, protokolluar pranë KPP me nr. 960/3 prot., datë 08.04.2026, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë KPP-së aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet se e ka refuzuar atë.

II.6. Me anë të shkresës datë 10.04.2025, protokolluar me tonën me nr. 960/4 prot., datë 14.04.2026, me objekt “Kundër-Argument ndaj vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) Mr.1404/6 prot., datë 03.04.2026”, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur kundër argumenta, në lidhje me vendimin e KSHA.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se “[...] Nga kjo dispozite rezulton se viti financiar 2025 është një vit tatimor i perfunduar plotësisht me date 31.12.2025 dhe, si i tillë, perben një periudhë të mbyllur dhe të verifikueshme për qëllime të vleresimit të kapaciteteve ekonomiko-financiare të operatoreve ekonomike.

17. Per rrjedhojë, perjashtimi i këtij viti nga kriteri i kualifikimit, nderkohe që ai perben një nga 3 vitet e fundit financiare, bie ndesh me logjikën e vetë dispozites ligjore dhe me kërkesën për vleresim të situatës ekonomike aktuale të operatoreve ekonomike.

18. Në këto kushte, kërkesa për të marrë në konsideratë vitet 2022-2023-2024, duke perjashtuar vitin 2025, perben një kufizim të pajustificuar dhe të paarsyeshëm, i cili cenon konkurrencën dhe vendos në mënyrë të padrejte në disavantazh operatorët ekonomike që permbushin kriterin në bazë të performancës së tyre me të fundit financiare.

19. Për sa më sipër, kërkojmë ndryshimin e kriterit të kualifikimit të referuar më sipër, si vijon:

#### 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomike duhet të paraqesin vertetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

*Kërkesa e mesiperme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar* [...], Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 11, “Kriteret e veçanta të kualifikimit” në pikën 2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë:

*2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.*

*Kërkesa e mesiperme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar..*

III.1.2. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” , të Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikon se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

III.1.3. Neni 3 Parime të përgjithshme, të Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikon se:

*1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

*2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*

*3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.1.4. Neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon shprehimisht se:

*1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti 7 kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

III.1.5. Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve*

*Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

*III.1.6. Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” pika 2, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.*

*Ndërsa në nenin 43, “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare” pika 1 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”*

*III.1.7. KPP gjykon, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.*

*III.1.8. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes për modifikimin e kriterit të përcaktuar në pikën 2.2.1 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se ky kriter është hartuar në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik, ku*

konkretisht, në Nenin 43, pika 1 e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet, se autoriteti/enti kontraktor për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Procedura e prokurimit objekt - ankimi është publikuar në datën 25.03.2026, ndërkohë periudha e përcaktuar në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, për deklarimin e xhiros vjetore, është 2022, 2023, 2024, periudhë cila është në përputhje me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, ku në nenin 29, pika 1 thuhet se: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji...”. Sa më sipër, në kushtet kur bilanci kontabël përgatitet brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, si dhe duke qenë se procedura e prokurimit është publikuar në datë 25.03.2026, kërkesa e autoritetit kontraktor për xhiron vjetore për periudhën 2022, 2023, 2024, është hatuar në përputhje me legjislacionin në fuqi si më sipër cituar, pasi afati përfundimtar për paraqitjen e bilancit kontabël për vitin 2025 (mbi bazën e të cilit lëshohet dhe vërtetimi mbi xhiron), është data 31.03.2026, ndërkohë që procedura e prokurimit objekt ankimi është publikuar përpara kësaj date. Në këtë kuptim, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor ka hartuar kriterin në lidhje me xhiron në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Kombi Invest” ShPK, se: “[...] Kërkesa që Pergjegjesi i shërbimit duhet të jete me profesion kimist/bioteknolog/inxhinier mjedisi dhe të kete eksperience pune të ngjashme të pakten 2 (dy) vite eshte e pabazuar ne ligj dhe e pajustificuar ne raport me natyren e shërbimit objekt prokurimi.

21. Ne lidhje me kete kriter, ankuesi nuk kundërshton kërkesen për një profil të caktuar profesional për pergjegjesin e shërbimit, por kundërshton kërkesen shtese për eksperience të detyrueshme prej të pakten 2 (dy) vitesh, si një kusht të panevojshëm dhe disproporcional.

22. Ne legjislacionin për prokurimin publik nuk ekziston asnjë dispozite që imponon detyrimisht një nivel të tillë eksperience për kete kategori shërbimi, nderkohe që vete autoriteti kontraktor nuk ka dhene një argumentim konkret që të justifikojë domosdoshmerine e kesaj kerkese.

[...] Per arsyet e analizuara me siper, kerkojme ndryshimin e kriterit si ne vijim:

2.3.5 Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht 13 (trembëdhjetë) persona të punësuar, në profilet sipas tabelës si mëposhtme:

NR. Staf Nr.

1 Përgjegjës Shërbimi 1 (një)

2 Punëtorë në Lavanderi 5 (pesë)

3 Punonjës Shërbimi në Reparte në AK7 (shtatë)  
Totali i punonjësve 14 (trembëdhjete)

c) Përgjegjësi i shërbimit,

Për Përgjegjësin e shërbimit, OE duhet të paraqesë:

- Kontratë individuale pune (e vlefshme), si Përgjegjës shërbimi;

d) Për punonjësit në pikat 2, 3 në tabelën më sipër, të paraqitet kontratë individuale pune (e vlefshme) përkatëse.[...], Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 11, pika 2.3.5 “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.5 Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë minimalisht 13 (trembëdhjetë) persona të punësuar, në profilet sipas tabelës si mëposhtme:

NR.	Stafi	Nr.
1	Përgjegjës Shërbimi	1 (një)
2	Punëtore në Lavanderi	5 (pesë)
3	Punonjës Shërbimi në Reparte në AK	7 (shtatë)
	<b>Totali i punonjësve</b>	<b>15 (trembëdhjete)</b>

d) Përgjegjësi i shërbimit, duhet të jetë me profesion kimist/bioteknolog/inxhinier mjedisi duhet të ketë eksperiencë pune të ngjashme të paktën 2 (dy) vite.

Për Përgjegjësin e shërbimit, OE duhet të paraqesë:

- Kontratë individuale pune (e vlefshme), si Përgjegjës shërbimi;

- Diplomë e arsimit të lartë;

- Librezë pune/ deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ cv dhe/ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton ekpseriencën e kërkuar.

e) Për punonjësit në pikat 2, 3 në tabelën më sipër, të paraqitet kontratë individuale pune (e vlefshme) përkatëse.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 12 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga të gjithë kandidatët e kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

III.2.2. Në shtojcën 8, “FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE”, Pjesa II, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

### **PJESA II – SPECIFIKIMET TEKNIKE DHE MENAXHIMI I PROCESIT TË LAVANDERISË**

Operatori ekonomik privat që do të kontraktohet, duhet të ofrojë një shërbim, i cili do të përfshijë:

- *Grumbullimin e materialit të butë të papastër në të gjitha pavionet e Spitalit Memorial Fier sipas grafikëve të përcaktuar, rregulloreve dhe protokolleve të higjenës dhe manualeve të kujdesit spitalor;*
- *Larjen e materialit të butë;*
- *Tharjen e materialit të butë,*
- *Hekurosjen dhe paketimin e materialit të butë;*
- *Shpërndarjen e materialit të butë në të gjitha shërbimet dhe pavionet e Spitalit Memorial Fier ,sipas grafikëve të përcaktuar;*
- *Shtrimin e shtratit të pacientit;*

*Shërbimi do të ofrohet gjatë gjithë javës prej ditës së hënë deri ditën e diel (operatori ekonomik privat, duhet të sigurojë edhe materialin e butë për mbulimin e nevojave në pavione, dhe shtrimin e shtratit të pacientit gjatë fundjavës) si dhe lënien e bazës materiale rezerve për nevoja të shërbimit gjatë shtrimeve të reja natën, urgjencave, por edhe sipas grafikut të përcaktuar për ndërrimin periodik të materialit të butë në shërbimet përkatëse, dhe sipas kërkesës së Kryeinfermierëve të pavionit në rast të ndërrimit të materialit të butë kur bëhet i domosdoshëm për pacientë të vecantë.*

*[...]*

III.2.3. Në Procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka argumentuar si më poshtë vijon:

**Argumentimi:** *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.*

*Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e natyrës së objektit të prokurimit, specifikimeve teknike, frekuencës së ekzekutimit të kontratës/ava, që do të lidhen dhe termave të referencës, hartuar nga AK.*

*Në tabelën e mësipërme është përcaktuar numri minimal i punonjësve, të cilët vlerësohen të nevojshëm për kryerjen e proceseve të punës, të cilat përfshin shërbimi i lavanderisë, si më poshtë:*

*Përgjegjësi i shërbimit ka një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e shërbimit të lavanderisë, dhe të gjitha proceseve të punës, të përfshirë në këtë proces, duke mbajtur përgjegjësi për zbatimin e objektit të prokurimit, në përmbushje të standarteve të cilësisë, specifikimeve teknike, dhe kushteve teknike të kërkuara. Është vlerësuar e nevojshme që drejtuesi teknik/përgjegjësi i shërbimit të ketë një nga profesionet si: kimist/bioteknolog/inxhinier mjedisi, si profesione të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, pasi kanë njohuri të specializuara mbi proceset kimike dhe biologjike që përfshihen në larjen, dezinfektimin dhe sterilizimin e tekstileve spitalore, aftësi*

për të menaxhuar rreziqet biologjike dhe ndotjet, si dhe për të garantuar higjienizimin sipas protokollove shëndetësore. Kimisti siguron menaxhimin korrekt të kimikateve, garanton dozimin dhe përqendrimet e duhura për efektivitet maksimal, parandalon reaksione të rrezikshme kimike dhe dëmtimin e materialeve./Bioteknologu siguron efektivitetin e proceseve të dezinfektimit dhe sterilizimit, ndihmon në parandalimin e përhapjes së infeksioneve, vlerëson ndikimin biologjik të proceseve të lavanderisë./Inxhinieri i mjedisit ka njohuri të avancuara mbi trajtimin e ujrave të ndotura dhe kimikateve që përdoren gjatë procesit të larjes, duke garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe respektimin e legjislacionit përkatës, kontrollin e ndikimit mjedisor të aktivitetit objekt prokurimi, veçanërisht në menaxhimin e mbetjeve me ngarkesë biologjike apo kimike, si dhe është i aftë të organizojë dhe zbatojë sisteme për monitorimin e ndotjes dhe sigurisë, të domosdoshme për shërbime që veprojnë në kushte higjeno-sanitare të kontrolluara.

Vitet e eksperiencës për përgjegjësin e shërbimit, janë vendosur duke mbajtur në konsideratë natyrën komplekse të shërbimit, objekt prokurimi, dhe proceseve të përfshira në lavanderinë profesionale:

Menaxhimi i cikleve të larjes dhe dezinfektimit, kontrolli i procesve të tharjes dhe hekurosjes, standartizimi i paketimit dhe ruajtjes, organizimi i dorëzimit dhe logjistikës, kontrolli i vazhdueshëm i higjienës dhe dezinfektimit, si dhe ndërlidhjen e të gjitha proceseve (ku cdo proces kërkon aftësi të konsoliduara në menaxhimin e të gjithë zinxhirit, duke garantuar cilësi dhe siguri). Gjithashtu, eksperiencia e paktën 2 viteve, siguron AK se përgjegjësi i shërbimit ka eksperiencë të mjaftueshme për të përballuar situata reale dhe aftësi praktike në zgjidhjen e tyre, për të ndërtuar protokolle funksionale dhe cilësi të qëndrueshme të realizimit të shërbimit, organizimin e stafit dhe zbatimin e të gjitha proceseve të shërbimit, në përputhje me kërkesat e mjedisit spitalor. Proceset e lavanderisë kërkojnë përvojë reale në menaxhimin e tyre dhe kjo eksperiencë e kërkuar siguron vazhdimësi dhe stabilitet në menaxhimin e të gjitha proceseve.

Disponimi i punëtorëve në lavanderi siguron AK që ofertuesit zotërojnë personelin e nevojshëm për të kryer proceset e larjes, tharjes, hekurosjes, paketimit, në kohë dhe me cilësinë e kërkuar.

Punonjës shërbimi në reparte janë të nevojshëm për të kryer proceset e marrjes dhe ndarjes së materialeve nga spitali, zëvendësimin e materialeve të buta, shtrimin e tyre.

Numri i punonjësve të kërkuar është caktuar duke u bazuar në natyrën dhe numrin/frekuencën e shërbimeve, objekt prokurimi dhe proceset e punës në të cilat duhe të përmbushë ky shërbim.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë/dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

III.2.4. Në nenin 2 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Në nenin 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronjë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.5. Në nenin 21 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi

III.2.6. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.2.7. Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” pika 2, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “ 2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.2.8. Në nenin 41 pika 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

III.2.9. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike, në përputhje dhe në përpjesëtim me volumin e kontratës të përcaktuar në dokumentet e tenderit. Për autoritetin kontraktor është tepër e rëndësishme që të sigurohet që shërbimi objekt-prokurimi i ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të jetë në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin apo vendosjen e kriterëve specifike, që në thelb konsiderohen si kritere fituese, për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e

*kontratës (ii) Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese.*

Referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues të paraqitur në ankesë, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin nëse kjo kërkesë është në proporcion me objektin e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77 pika 1 të LPP-së.

Në rastin konkret Komisioni konstaton, se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi, se subjektet ofertues zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës.

Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, specifikimeve teknike, grafikut të lëvrimit si dhe volumit të shërbimit, Komisioni gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor lidhur me eksperiencën e përgjegjësit të shërbimit si dhe kualifikimin e tij, është një kërkesë e domosdoshme, e cila duhet hartuar në përputhje me frymën e ligjit dhe të rregullave të prokurimit publik, me qëllim hapjen e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik të interesuar, në proporcion me shërbimin që do të kryhet.

Autoriteti kontraktor kërkon të krijojë një panoramë të përgjithshme për verifikimin e kapaciteteve të shoqërive pjesëmarrëse, të cilët duhet të vërtetojnë në lidhje me punonjësit se kanë një personel të nevojshëm, të pajisur me kualifikimet përkatëse ku përfshihen edhe dëshmitë e kualifikimit në lidhje me profesionin e tyre, për të zbatuar kontratën në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Konkretisht, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, mbi kualifikimet e përgjegjësit të shërbimit si dhe eksperiencën e tij, vërejmë se, objekti i prokurimit është shërbim i lavanterisë për pacientët e hospitalizuar, ku ndër të tjera përfshihen specifikimet teknike dhe menaxhimi i proceseve si grumbullimi i materialit të butë të papastër në të gjitha pavionet e Spitalit Memorial Fier sipas grafikëve të përcaktuar, rregulloreve dhe protokolleve të higjenes dhe manualeve të kujdesit spitalor; Larjen e materialit të butë; Tharjen e materialit të butë; Hekurosjen dhe paketimin e materialit të butë; Shpërndarjen e materialit të butë në të gjitha shërbimet dhe pavionet e Spitalit Memorial Fier, sipas grafikëve të përcaktuar; Shtrimin e shtratit të pacientit; duke përfshirë kështu ndër të tjera një proces i cili duhet të kryhet sipas rregulloreve dhe protokolleve të higjenes dhe manualeve të kujdesit spitalor. Pra rrjedhimisht, duke qenë se

kemi të bëjmë me një shërbim të rëndësishëm dhe sensitiv, siç është higjiena e spitalit, kërkesa e autoritetit kontraktor që përgjegjësi i shërbimit të jetë me profesion kimist/bioteknolog/inxhinier mjedisi, si dhe të ketë eksperiencën në punë, janë kërkesa të domosdoshme, por autoriteti kontraktor duhet ti modifikojë këto kërkesa, duke përfshirë dhe kualifikime të tjera ekuivalente, me qëllim hapjen e pjesëmarrjes së të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi, që mund të zotërojnë kualifikime ekuivalente që ti shërbejnë qëllimit të vendosjes së këtij kriteri, si dhe të ulë në proporcion me objektin e prokurimit, eksperiencën e punës së përgjegjësit të shërbimit.

Në këtë kuptim referuar bazës ligjore sa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të kryejë modifikimin e kriterit duke rishikuar edhe njëherë kualifikimin dhe eksperiencën në punë të përgjegjësit të shërbimit, në proporcion me objektin e prokurimit në respekt të hapjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë pjesërisht.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Kombi Invest” SHPK për pikën 2.3.6 të dokumenteve të tenderit për të cilin kërkon: “[...] Ky kriter perben nje kufizim te drejtperdrejte dhe te pajustificuar te menyres se organizimit te brendshem te operatoreve ekonomike, duke nderhyre ne marredheniet e tyre te punes dhe ne te drejten per te menaxhuar burimet njerezore ne menyre te lire. Ne legjislacionin per prokurimin publik nuk ekziston asnje dispozite qe lejon autoritetin kontraktor te vendose kufizime te tilla mbi punesimin e stafit te operatoreve ekonomike, pertej kerkesave qe lidhen me aftesine per realizimin e kontrates. Punonjesit, ne perputhje me legjislacionin e punes, jane te angazhuar per nje kohe pune te caktuar (p.sh. 8 ore ne dite) dhe nuk ekziston asnje ndalim ligjor qe ata te mos angazhohen ne me shume se nje kontrate apo aktivitet, per sa kohe respektohen kufijte ligjore te kohes se punes.

37. Per rrjedhoje, kerkesa qe punonjesit te mos jene te angazhuar ne kontrata te tjera gjate gjithe periudhes se vlefshmerise se marreveshjes kuader perben nje kufizim te pajustificuar dhe te tepruar, i cili nuk lidhet ne menyre proporcionale me objektin e kontrates. [...].”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 11 të dokumenteve të tenderit, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.6 autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

2.3.6. Operatorët ekonomikë ofertues duhet të deklarojnë se punonjësit e deklaruar për këtë procedurë prokurimi: Punonjës Shërbimi në Reparte në AK nuk do të jenë të angazhuar në kontrata të tjera gjatë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër.

III.3.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;  
ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;  
d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;  
dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”  
Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale.  
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.  
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.3.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.3.4. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;  
b) gjendjen ekonomike dhe financiare;  
c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar

kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.3.5. Ndërsa në nenin 41 pika 2 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar përcaktohet se: “2. *Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*”

III.3.6. Në procesverbalin e argumentimit të kriterëve për kualifikim dhe të specifikimeve teknike lidhur me këto kriterë autoriteti kontraktor ka argumentuar: “*Argumentimi: Në zbatim të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, si dhe duke vlerësuar ndjeshmërinë e shërbimeve, objekt prokurimi, ku kërkohet një shërbim i përditshëm me orare të përcaktuara, punonjësit e shërbimit në reparte të AK kërkohet të mos jenë të angazhuar në kontrata të tjera gjatë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër, duke garantuar kështu ekzekutimin e kontratës/kontratave që do të nënshkruhen në zbatim të marrëveshjes kuadër, në kohë dhe cilësi. Realizimi në kohë i shërbimit është shumë i rëndësishëm për këtë procedurë prokurimi, pasi lidhet drejtëpërdrejtë me shërbimin ndaj pacientëve në spital.*”

III.3.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt - prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese.

Në rastin konkret, lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktor që “*Operatorët ekonomikë ofertues duhet të deklarojnë se punonjësit e deklaruar për këtë procedurë prokurimi: Punonjës shërbimi në Reparte të AK nuk do të jenë të angazhuar në kontrata të tjera gjatë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër.*” KPP gjykon se kjo kërkesë është kufizuese cënon konkurrencën dhe nuk nxit pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit si dhe bie ndesh me qëllimin e ligjit të prokurimit publik për nxitjen e konkurrencës dhe sigurimin e një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Në dokumentet standarte të tenderit të miratuara nga Agjencia e Prokurimit

Publik përmes kompetencave që i jep ligji është përcaktuar se deklarimi i punonjësve dhe mjeteve (nëse kërkohen) bëhet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të cilin në kuptim të nenit 82 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar autoritetet ose entet kontraktore e pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta. Konkretisht në Pjesa III “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit”, B. DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)” është përcaktuar qartë se numri i punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen) përcaktohet përmes deklarimit në këtë seksion, Këto deklarime shërbejnë si provë paraprake e cila pas publikimit të njoftimit të fituesit paraprak për operatorin ekonomik të renditur i pari i nënshtrohen verifikimeve nga autoriteti kontraktor. Komisioni shkon akoma më tej në arsyetimin e tij duke gjykuar se kërkesa e mësipërme haptazi cënon interesin e ligjshëm të operatorëve ekonomikë për të marrë pjesë në disa procedura prokurimi në të njëjtën kohë pasi e lidh ngushtësisht prezencën e stafit (në këtë rast 7 Punonjës Shërbimi në Reparte në AK) që të jetë i angazhuar vetëm për këtë objekt ndërkohë që vetë procedura e prokurimit publik përfshin një cikël të gjatë i cili deklaron shpalljen fitues dhe finalizohet me lidhjen e kontratës. Komisioni gjykon se deklarimi si fitues jo domosdoshmërisht çon në lidhjen e kontratës, por edhe për ato raste kur kontratat si veprime juridik me anë të së cilave një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike lidhën me autoritetet/enet kontraktore në bazë të një procedure të prokurimit publik kanë fazat e tyre të ekzekutimit ku jo të gjitha këto faza kërkojnë prezencën e stafit të një profili të caktuar, prandaj autoriteti kontraktor nuk mund të kufizojë operatorët ekonomikë që stafi i kërkuar prej 7 Punonjës Shërbimi në Reparte në AK nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, gjatë periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër. Përcaktimi i mësipërm i autoritetit kontraktor që Punonjësit e Shërbimit në Reparte në AK nuk duhet të jenë të angazhuar në kontrata të tjera, për shkak se cënon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik në disa procedura prokurimit njëkohësisht bie dhe në kundërshtim me qëllimin e vetë legjislativitetit të prokurimit publik i cili synon nxitjen e një pjesëmarrje sa më të gjerë të operatorëve në këto procedura dhe rritjen e konkurrencës. Sa më sipër arsyetuar KPP gjykon se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit 2.3.6 të dokumenteve të tenderit duke hequr atë.

Sa më lart pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Kombi Invest” ShPK, se: “[...] Kundërshtojme kriterin e veçante të kualifikimit 2.3.7 si kriter të pajustifikuar, disproporcional dhe kufizues të konkurrencës:

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se disponon, makinerite, dhe pajisjet, si më poshtë:

1 Makinë larëse profesionale (me kapacitet mbi 60 kg secila) copë 2 (dy) ose me kombinim pajisjesh, për plotësimin e sasisë së përcaktuar nga AK.

2 *Barriera larese profesionale (për larjen e materialeve të kontaminuara) me kapacitet mbi 60 kg secila. copë 1 (nje) ose me kombinim pajisjesh, per plotesimin e sasise se percaktuar nga AK.*

*Kriteri i mesiperm ne lidhje me kapacitetin e Makinave larese dhe barrierave larese profesionale mbi 60 kg secila, perben nje kufizim te pajustificuar te konkurrences, pasi percakton ne menyre te ngurte dhe te tepruar kapacitete minimale te pajisjeve, pa nje lidhje reale dhe proporcionale me volumin e sherbimit qe kerkohet te realizohet.*

[...]

*Kundershtojme kriterin e veçante te kualifikimit 2.3.7 si kriter te pajustificuar, disproporcional dhe kufizues te konkurrences:*

*“Makine pastrimi kimik profesionale (per jorgan, vatine dhe jastek, me kapacitet mbi 20 kg) 1 (nje) ose me kombinim pajisjesh, per plotesimin e sasise se percaktuar nga AK “ si kriter diskriminues dhe perjashtues.*

[...]

*Kundershtojme kriterin e veçante te kualifikimit 2.3.7 si kriter te pajustificuar, disproporcional dhe kufizues te konkurrences:*

*“Peshore elektronike mbi 100 kg, e cila duhet te jete e kalibruar dhe te shoqerohet me akt kolaudimi te leshuar nga autoritetet perkatese (Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise) 2 (dy) cope si kriter te pajustificuar, disproporcional dhe kufizues te konkurrences.” [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.4.1. Në shtojcën 11, pika 2.3.7 “*Kapaciteti teknik*”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të deklaroje se disponon, makinerite, dhe pajisjet, si më poshtë:

<b>Nr</b>	<b>Emri i mjetit</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasitë minimale</b>
1	<i>Makinë larëse profesionale (me kapacitet mbi 60 kg secila)</i>	<i>copë</i>	<i>2 (dy) ose me kombinim pajisjesh, per plotesimin e sasise se percaktuar nga AK.</i>
2	<i>Barriera larese profesionale (për larjen e materialeve të kontaminuara) me kapacitet mbi 60 kg secila.</i>	<i>copë</i>	<i>1 (nje) ose me kombinim pajisjesh, per plotesimin e sasise se percaktuar nga AK.</i>
3	<i>Makinë pastrimi kimik profesionale (për jorgan Vatine dhe jastëk, me kapacitet mbi 20 kg)</i>	<i>copë</i>	<i>1 (nje) ose me kombinim pajisjesh, per plotesimin e sasise se percaktuar nga AK.</i>

[...]

13	<i>Peshore elektronike mbi 100 kg e cila duhet te jete kalibruar dhe te shoqerohet me akt kolaudimi te leshuar nga autoritetet perkatese( Drejtoria e Pergjithshme e Metrologjise)</i>	<i>Cope</i>	2 (dy)
----	--	-------------	--------

[...]

III.4.2. Në shtojcën 9, “FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

**Shërbimi që kërkohet: Shërbimi i lavanderisë për pacientët e hospitalizuar në pavionet e Spitalit Memorial Fier**

<b>Shërbimi</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Shuma totale për 48 muaj</b>	<b>Vendi i ekzekutimit</b>	<b>Afati i ekzekutimit</b>
Shërbimi i lavanderisë për pacientët e hospitalizuar në pavionet e Spitalit Memorial Fier	Sipas specifikimeve teknike dhe termave të referencës	496, 000 kg	Në pavionet e Spitalit Memorial Fier	Sipas nevojave të AK, brenda periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër

**Afatet e ekzekutimit:** 48 muaj nga nënshkrimi i marrëveshjes kuadër, sipas nevojave të AK

III.4.3. Në Procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka argumentuar si më poshtë vijon:

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet për kryerjen e shërbimit të lavanderisë dhe të gjitha proceseve të tij, si: larje, tharje, hekurosjë, ndarja- marrja e materialeve të buta sipas ndotjes dhe shtrimin e tyre. Nisur nga rëndësia e ruajtjes së higjenës për shërbimin e lavanderisë, vecanërisht në ambientet spitalore, janë vendosur gjithashtu edhe pompa dizinfektante në karrocet shërbimi në pavione, me qëllim përmbushjen e protokollove të zbatueshme, parandalimin e transferimit të baktereve/viruseve nga një ngarkesë në tjetrën, si dhe materiali i butë i cili do të shpërndahet në pavione të mbetet i sigurtë për përdorim.

Duke qenë se njësia matëse e objektit të prokurimit, është kg, dhe OE do të ofertojnë për njësinë në kg, disponimi i peshores, lidhet drejtëpërdrejtë me ekzekutimin me sukses të kontratës.

*Disponimi i këtyre mjeteve (lloji, sasia dhe pesha) është vendosur bazuar në proceset e punës të shërbimit objekt prokurimit, si dhe sasisë së parashikuar nga AK të materialeve që do të lahen, duke shërbyer si garanci e AK që shërbimi, objekt prokurimi do të kryhet me cilësi dhe konform të gjitha kërkesave të AK.*

III.4.4. Në nenin 2 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Në nenin 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.4.5. Në nenin 21 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi

III.4.6. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

[...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.4.7. Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” pika 2, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “ 2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.4.8. Në nenin 41 pika 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

d) Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

III.4.9. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e

nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike, në përputhje dhe në përpjesëtim me volumin e kontratës të përcaktuar në dokumentet e tenderit. Për autoritetin kontraktor është tepër e rëndësishme që të sigurohet që shërbimi objekt-prokurimi i ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të jetë në përputhje me kërkesat në dokumentet e tenderit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në përcaktimin apo vendosjen e kriterëve specifike, që në thelb konsiderohen si kriterë fituese, për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoriteteve kontraktore brenda diskrecionit që ka në përzgjedhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë se përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë: (i) në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës (ii) Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi. Autoriteti kontraktues është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret për kualifikim, mjafton që ato të mos jenë diskriminuese e përjashtuese.

Referuar pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues të paraqitur në ankesë, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin nëse kjo kërkesë është në proporcion me objektin e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77 pika 1 të LPP-së. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (pajisje), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit.

KPP gjykon se autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kriterë të tepruara dhe që nuk i shërbejnë qëllimit final të autoritetit kontraktor për një realizim të sukseshëm të kontratës. Sa më sipër, nisur nga pretendimet e ankimuesit mbi uljen e kapacitetit të pajisjeve si *Makinë larëse profesionale (me kapacitet mbi 60 kg secila)*; *Barriera larëse profesionale (për larjen e materialeve të kontaminuara) me kapacitet mbi 60 kg secila*; *Makinë pastrimi kimik profesionale (për jorgan Vatine dhe jastëk, me kapacitet mbi 20 kg)*, si dhe *Peshore elektronike mbi 100 kg e cila duhet të jete kalibruar dhe të shoqërohet me akt kolaudimi të lëshuar nga autoritetet përkatëse (Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë)*, KPP gjykon se nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, specifikimeve teknike, grafikut të lëvrimit si dhe volumit të shërbimit,

Komisioni gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor mbi pajisjet e mësipërme është e nevojshme për realizimin e shërbimit objekt prokurimi, por përcaktimi i kapacitetit të tyre, duhet të vijë pas një analize të hollësishme të të gjithë elementëve të procedurës së prokurimit si volumi, natyra, grafiku të ekzekutimit, afati i kontratës etj., gjë e cila nuk rezulton të jetë analizuar nga ana e autoritetit kontraktor.

Bazuar në të gjithë elementët e cituar më lart, Komisioni gjykon se, kërkesat mbi kapacitetin e pajisjeve *Makinë larëse profesionale (me kapacitet mbi 60 kg secila); Barriera larëse profesionale me kapacitet mbi 60 kg secila; Makinë pastrimi kimik profesionale (me kapacitet mbi 20 kg), si dhe Peshore elektronike mbi 100 kg*, janë një kërkesë e pajustificuar nga autoriteti kontraktor. Komisioni thekson se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet disponimi i pajisjeve me kapacitet mbajtës të caktuar, por ky tregues i pajisjeve duhet të vijë pas një analize gjithëpërfshirëse të autoriteti kontraktor, i të gjithë elementëve të cituara më sipër, me qëllim përcaktimin e saktë të tij, në mënyrë të arsyeshme, proporcionale, si dhe në përputhje me nevojat reale, për ekzekutimin e kontratës në mënyrë të suksesshme, në respekt të nenit 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në këtë kuptim, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e mësipërm, duke rishikuar kapacitetin e pajisjeve objekt ankimi, në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës objekt shqyrtimi.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë pjesërisht.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Kombi Invest” SHPK se *“Kundershtojme përcaktimin në Dokumentet Standarde të Tenderit, pika 2.16 “Mbeshtetja në kapacitetet e subjekteve të tjera , si në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik dhe si kufizim i pajustificuar i konkurrencës.” Autoriteti kontraktor ka përcaktuar se operatorët ekonomikë ndalohen të mbeshteten në kapacitetet e subjekteve të tjera për plotësimin e kriterëve të kualifikimit 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar dhe 2.3 Kapaciteti teknik .*

*Ky përcaktim bie në kundërshtim të drejtperdrejtë me nenin 84 të Ligjit nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik , i cili parashikon shprehimisht se operatori ekonomik ka të drejtë të mbeshtetet në kapacitetet ekonomike, financiare dhe teknike të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve me to. [...] Në keto kushte, vendosja e një ndalimi të përgjithshëm për mbeshtetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera përben një kufizim të pajustificuar dhe disproporcional të konkurrencës, duke përjashtuar operatorët ekonomikë që, në përputhje me ligjin, mund të realizojnë kontratën përmes bashkëpunimit dhe përdorimit të burimeve të*

subjekteve te tjera. Per rrjedhoje, kjo dispozite eshte ne kundërshtim me nenin 84 te Ligjit nr. 162/2020 Per Prokurimin Publik , si dhe me parimet themelore te konkurrencës, proporcionalitetit dhe trajtimit te barabarte. Ne keto kushte, kerkojme shfuqizimin e ketij kufizimi dhe lejimin e operatoreve ekonomike per tu mbështetur ne kapacitetet e subjekteve te tjera, ne perputhje me nenin 84 te ligjit. ” KPP vëren se,

III.5.1. Në pikën 2.16 të dokumenteve të tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë:

### **2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:**

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilën ofertuesi ndalohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

**Po**

**X**

**Jo**

#### **Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që ndalohet mbështetja:**

Ndalohet mbështetja për seksionin e kushteve të vecanta për kualifikim 2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” dhe “2.3 Kapaciteti teknik” pasi kapacitetet ekonomiko-financiare dhe teknike janë të domosdoshme për realizimin e kontratës objekt prokurimi dhe janë të lidhura ngushtësisht me oferteusin, pasi tregojnë kapacitete reale të tij. Shërbimi objekt prokurimi ka natyrë shërbimi periodik, në ambientet e Spitalit Rajonal “Memorial” Fier, dhe rëndësi jetike për funksionimin e këtij spitali. Karakteri specifik dhe i vazhdueshëm operacional, me një kohëzgjatje relativisht të gjatë prej 48 muajsh, kërkon kapacitete reale ekonomike, teknike, përvojë, infrastrukturë të dedikuar, logjistike të posaçme, siguri teknike të zbatimit të kontratës, me qëllim përmbushjen e standarteve të cilësisë së kujdesit shëndetësor, ruajtjen e higjenes dhe mbrojtjen e shëndetit publik brenda ambienteve spitalore. Këto kritere vlerësohen si karakteristika të vetë subjektit ofertues, të cilat tregojnë nëse ai është i aftë të përballojë detyrimet kontraktore, sipas përcaktimeve dhe kushteve të vendosura nga AK. Si rrjedhojë, ndalimi i mbështetjes në këto kritere garanton përgjegjësi të drejtëpërdrejtë, besueshmëri në ekzekutimin e kontratës/ave, si dhe vazhdueshmëri të shërbimit.

III.5.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

*dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

*2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*

*3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.5.3. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.5.4. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

*1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

*c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”*

III.5.5. Në nenin 84 pika 1,3 dhe 6 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *“1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të*

*përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta.*

*3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.*

*6. Ndërkohë, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm.”*

III.5.6. Në nenin 41 pika 2 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar përcaktohet se: “2. *Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.5.7. Në nenin 90 pika 1 dhe 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar parashikohet se: “1. *Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.*

*6.Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti/enti kontraktor, mund të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ofertuesi. Ky informacion publikohet në dokumentet e tenderit.”*

III.5.8. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni vlereson, se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe përmasat/volumin e kontratës. Në rastin konkret e rëndësishme për autoritetin kontraktor, referuar natyrës së kontratës është realizimi i objektit të prokurimit në përputhje me specifikimet teknike natyrën dhe përmasat e kontratës në fjalë. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe

organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret duke marrë shkas nga pretendimet e ankimuesit i cili kërkon që të hiqet kufizimi i vënë nga autoriteti kontraktor që nuk lejon mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera për seksionin e kushteve të veçanta për kualifikim 2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” dhe 2.3 Kapaciteti teknik, nga shqyrtimi dokumenteve të tenderit rezulton se autoriteti kontraktor ka përcaktuar aspektet në të cilat nuk lejohet mbështetja dhe që kanë të mbëjnë me kufizimet e përmendura më sipër. KPP gjykon se ligjvënësi përmes *lex specialis* por edhe rregullat e prokurimit publik që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të ligjit kanë përcaktuar mundësinë e operatorëve ekonomikë ofertues për tu mbështetur në kapacitetet teknike, profesionale dhe ekonomike të subjekteve të tjera ashtu sikurse kanë lënë në diskrecionin e autoriteti kontraktor që të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës ofruesi të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ai me kushtin që ky informacion të publikohet në dokumentet e tenderit. Fakti që ligji dhe rregullat e prokurimit publik i kanë dhënë diskrecionin autoritetit kontraktor që të vendosë kufizime mbi aspekte të caktuara të mbështetjes në subjektet e tjera nuk do të thotë që ato të bëhen pa një argumentim të saktë dhe të detajuar që justifikon kufizime të tilla. Në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar në asnjë pikë pse nuk ka lejuar mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera pikërisht për seksionin 2.2 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” dhe 2.3 “Kapaciteti teknik”. Vetë ligjvënësi përmes ligjit për prokurimin publik, por edhe në rregullat e prokurimit publik ka kufizuar mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera për aspekte kritike ku autoriteti kontraktor në rastin konkret ka dështuar të argumentojë në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim pse dy seksionet e më sipër përbëjnë aspekte kritike në raport me aspekte të tjera për të cilat ka lejuar mbështetje në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Sa më lart autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për të rishikuar kërkesën e cila nuk lejon mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera duke qenë më i qartë dhe të mirëargumentojë hartimin e saj duke patur parasysh parashikimet e nenit 90 pika 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar lidhur me aspektet kritike ose në të kundërt të heqë kufizimet më sipër lidhur me mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë pjesërisht.

III.6. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Kombi Invest” SHPK se “*Nga shqyrtimi i Dokumenteve Standarde të Tenderit rezulton se në asnjë pjesë të tyre nuk specifikohet qarte nëse procedura e prokurimit zhvillohet me një fazë apo me dy faza.*”

*Mungesa e ketij informacioni thelbesor krijon paqartesi dhe konfuzion per operatoret ekonomike, duke lene vend per interpretime dhe keqinterpretime ne lidhje me menyren e zhvillimit te procedures dhe permbushjen e kerkesave perkatese.*

*Autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor qe ne Dokumentet Standarde te Tenderit te percaktoje ne menyre te qarte, te plote dhe te paekuivok te gjithe elementet thelbesore te procedures se prokurimit, ne menyre qe te garantohet transparencja, barazia dhe konkurrenca efektive ndermjet operatoreve ekonomike.*

*Ne mungese te ketij specifikimi, Dokumentet e Tenderit rezultojne te paplota dhe ne kundershtrim me parimet e transparences dhe qartesis se procedures.*

*Per rrjedhoje, kerkojme plotesimin e Dokumenteve Standarde te Tenderit, duke specifikuar qarte nese procedura e prokurimit zhvillohet me nje faze apo me dy faza.. ” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.6.1. Në Seksionin 4 “Njoftimi i kontratës”, pika 4.1 të dokumenteve të tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë:

#### ***Seksioni 4: Procedura***

##### ***4.1 Lloji i procedurës: E Kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar***

III.6.2. Gjithashtu, në “Njoftimin e shkurtuar i kontratës”, të dokumentave të tenderit është përcaktuar:

***2. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar, Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara***

III.6.3. Në nenin 41, pika b) “Procedurat standarde të prokurimit” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

*1. Autoriteti ose enti kontraktor në përcaktimin e fituesve të kontratave publike zbaton procedurat e parashikuara në këtë ligj.*

*Llojet e procedurave të prokurimit publik janë:*

*a) procedurë e hapur;*

*b) procedurë e kufizuar;*

*[...]*

III.6.4. Ndërsa në nenin 43, pika 1 “Procedurë e kufizuar” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

*1. Procedura e kufizuar është procedurë me dy faza, në të cilën mund të marrë pjesë çdo operator ekonomik i interesuar, duke dorëzuar një kërkesë për pjesëmarrje në përgjigje të një njoftimi, i cili përmban informacionin e përcaktuar në rregullat e prokurimit publik.*

III.6.5. Në nenin 48 pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar parashikohet se:

*1.Procedura e kufizuar, sipas nenit 43, të LPP-së, është procedurë prokurimi me dy faza, që mund të përdoret nga çdo autoritet/ent kontraktor që prokuron punë/shërbime/mallra, në të cilën mund të marrë pjesë çdo operator ekonomik i interesuar.*

Ndërsa në nenin 14 pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar parashikohet se:

*1.APP-ja harton dhe miraton me vendim formatin e dokumenteve standarde të tenderit që do të përdoren gjatë procedurave të prokurimit, për çdo lloj procedure prokurimi sipas nenit 41, të LPP-së, dhe çdo tip kontrate.*

III.6.6. Sa më sipër, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, që në titullin e tyre, KPP vëren se autoriteti kontraktor ka përdorur dokumentat standarde të tenderit të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik sipas nenit 14 pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, për procedurën “Procedurë e kufizuar”. Gjithashtu, nga verifikimi i dokumentave të tenderit, konstatohet se në Seksionin 4 “Njoftimi i kontratës”, pika 4.1 autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë: **Lloji i procedurës: E Kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar, edhe në “Njoftimin e shkurtuar i kontratës”, të dokumentave të tenderit është përvcaktuar: Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar, Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.**

Sa më sipër, në kuptim të ligjit, referuar nenit 43, pika 1 “Procedurë e kufizuar” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 48 pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se procedura e kufizuar, është procedurë prokurimi me dy faza, që mund të përdoret nga çdo autoritet/ent kontraktor që prokuron punë/shërbime/mallra, në të cilën mund të marrë pjesë çdo operator ekonomik i interesuar.

Pra, qartësisht, konstatohet se autoriteti kontraktor ka përcaktuar sipas dokumentave standarde të tenderit, se ka përdorur llojin e procedurës “Procedurë e kufizuar”, duke plotësuar të gjitha seksionet e kërkuara sipas dokumentave të tenderit, mbi llojin e procedurës, në përputhje me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, ku rrjedhimisht në zbatim të ligjit përcaktohet shprehimisht se “Procedura e kufizuar” zhvillohet në dy faza.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e

*Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,*

### **Vendos:**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Kombi Invest” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-79678-03-19-2026, me objekt “*Shërbim i lavanderisë për pacientët e hospitalizuar në pavionet e Spitalit Rajonal “Memorial” Fier*”, me fond limit 188,480,000 lekë pa TVSH, me datë mbyllje për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje 20.04.2026, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në dokumentet e tenderit sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, duke publikuar të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vëre në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimes “Kombi Invest” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

